



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 1  
07.12.2018

NR. VENDIMI 1  
09.01.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA  
T I R A N Ë

Nr.1/26 Akti  
Dt. 07.12.2018

Nr. 1 Vendimi  
Dt. 09.01.2019

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë nga:

**GJYQTARE: IRENA GJOKA**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Blerina Sukaj**, sot me date **09.01.2019, dite e Mërkurë, ora 11.07, mori** në shqyrtim në seancë publike, kërkesën penale **nr.1/26** Akti me:

**KËRKUES:L.S.** i biri i H. dhe i F., dtl.xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë, me arsim të mesëm, profesion Mekanik, aktualisht i papunë, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, banues në Rr.xxxxx xxxxx, nr.xx, Shtëpi private, ose xx/x, i përfaqësuar në këtë gjykim, me prokurë të përgjithshme nr.9286 Rep, nr.1106 Kol, datë 30.04.2018, përpiluar nga Dhoma e Notereve Tirane, nga av. E. H. dhe E. H., me licensë nr.2790, Nipt K 81304013 L anëtar i Dhomës Avokatisë Tirane, tel.xxx, me adresë Bulv. Zogu Pare, pallati përballë Intesa San Paolo Bank, kati dytë Tiranë.

**OBJEKTI:**Kërkohet revokimi i sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme vendosur me vendimin Nr.04 datë 05.03.2018, të Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

**PALË E INTERESUAR:**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përfaqësuar nga prokurore D. M..

**BAZA LIGJORE:**Nenet 12/b të ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndyshuar me

ligjin Nr.70 viti 2017.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet e paraqitura, dëgjoi pretendimet përfundimtare të tyre sipas të cilëve kërkuan:

**Pala kërkuese përfaqësuesi i saj Av. E. H.;** Pranimin e kërkesës. Revokimin e sekuestros së vënë më vendimin nr.04 datë 05.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së parë për krime të Rënda Tiranë.

**Pala e interesuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përfaqësuar nga prokurori D. M.:** Pranimin e kërkesës së subjektivit L.S., për revokimin e sekuestros së vënë më vendimin nr.04 datë 05.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Si dhe pasi e vlerësoi kërkesën në tërësi;

## VËREN

Më datë 07.12.2018, në sekretarinë e kësaj Gjykate është depozituar për gjykim kërkesa, me kërkues L.S. me objekt, revokimin i sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme vendosur me vendimin Nr.4 datë 05.03.2018, të Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Në zbatim të nenit 12/b paragrafi i parë të ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, Gjykata me kërkesë të palëve vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë edhe përpara afatit të parashikuar nga pika 2 dhe 3 të nenit 12, të këtij ligji.

## Rrethanat e çështjes

Me vendimin Nr.4, datë 05.03.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, mbi kërkesë të Prokurorisë për Krime të Rënda, ka vendosur sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin personit nën hetim pasuror L.S.

Rrethanat mbi të cilat është vendosur sekuestrimi janë si vijon. Mbi bazën e referimit të bërë nga Seksioni për Hetimin e Aseteve Kriminale pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë si dhe nga informacioni i marrë nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë e cila po zhvillohen hetime në kuadër të procedimit penal Nr.5667/2014 për veprën penale të “Pastrimi produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka regjistruar referimin pasuror Nr. 52/2014 e më pas procedimin pasuror Nr.1/2018, në ngarkim të shtetasit L.H.S.

Nisur nga të dhënat paraprake të referuara ka rezultuar se shtetasi L.S. , i biri i H. dhe i F. lindur në datë xx.xx.xxxx në Tiranë, i martuar me shtetasen S.P.S., me të cilën ka dy fëmijëvë, është arrestuar në Spanjë për llogari të autoriteve gjermane dhe pas ekstradimit, është hetuar dhe gjykuar në Republikën Federale Gjermane nga Gjykata e Landit të Freiburgu, për veprën penale të parashikuar nga neni 29 a paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit “Për lëndët narkotike”, 25 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës Federale Gjermane. Në përfundim të gjykimit ai është dënuar me një dënim të përgjithshëm prej 5 (pesë) vjet heqje lirie. Ky vendim ka marrë formë të prerë në 6 Prill 2011.

Vendimi në fjalë ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur në datën 20.05.2010, në zonën e

Wiil am Reihn, ku shtetasit B.K., A.Xh., L.S. dhe H.C. i kanë shitur punonjësit të policisë federale gjermane, të infiltruar, një sasi prej 4.5 kg kokainë në këmbim të vlerës prej 216.000 euro. Pas dorëzimit të mallit, fillimisht janë ndaluar nga ndërhyrja e forcave të policisë gjermane shtetasit B.K. dhe A.Xh., ndërkohë që shtetasit L.S. dhe H.C. fillimisht kanë mundur të largohen, për t'u arrestuar më pas.

Mbështetur nga të dhënat e mësipërme të administruara në fashikullin e procedimit pasuror, rezulton se shtetasi L.S., i plotëson kriteret për të qënë subjekt i hetimit pasuror bazuar në nenin 3 pika 1/d) të Ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Nga hetimi pasuror i zhvilluar në kuadër të këtij materiali referues për shtetasin L.S. ka rezultuar se:Ky shtetas është i martuar me shtetasen S.P.S. e datëlidjes xx.xx.xxxx, lindur në Bogota Kolumbi dhe me banim në Shqipëri.Sipas certifikatës familjare së këtij shtetasi, rezulton se në përberjë të familjes së tij janë shtetasit H.M.S. dtl. xx.xx.xxxx (kryefamiljar), L.H.S. (i biri) dtl. xx.xx.xxxx, fëmijët F. (dtl. xx.xx.xxxx dhe L.S. (dtl. xx.xx.xxxx) dhe bashkëshortja, S.P.S. dtl. xx.xx.xxxx.

Ky vendim është vënë në ekzekutim, duke iu dërguar administratorit përkatës në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.Me shkresat me Nr.487 prot, datë 09.05.2018; Nr.416, datë 16.04.2018; Nr.707 prot, datë 10.07.2018; Nr.26.03.2018; “Informacion mbi zbatimin vendimit Nr.04 datë 05.03.2018,” Agjencia e Adminstrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, ka njoftuar per ekzekutimin e ketij vendimi, të pasurive të sekuestruara duke i bashkëngjitur këtyre shkresave një sërë aktesh, korespodencash, proces-verbale të Zyrove Pëmbartimore përkatëse, vërtetime nga dokumentat hipotekore të Zyrove Vendore të Pasurive të Palujtshme që lidhen me zbatimin e vendimit gjyqësor.

Sipas Procesverbalit për sekuestrimin e pasurive në zbatim të vendimit të gjykatës, datë 20.03.2018, është konstatuar se në pasuritë apartamente në zonën kadastrale, 8270 nr. pasurie 7/299 nga n r. 1-36, të ndodhur në rrugën Sami Frashëri, Tiranë, pallati 9-katësh, posedoheshin nga familjet përkatëse që i kishin blerë këto pasuri, nga kërkuesi L.S. me kontrata përkatëse të sipërmarrjeve.

Ky vendim pasi është ankimuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda me vendim Nr.49, datë 15.05.2018, kjo e fundit ka vendosur:Lënien në fuqi të vendimit Nr.04, datë 05.03.2018 të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë.

Nga përmbajtja e vendimit nr.49 datë 15.05.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, rezultoi se kjo e fundit konform parashkimeve të nenit 5/2 të ligjit 10192 datë 03.12.2009 dhe nenit 276/1, të K.Pr.Penale, legjitimoi ankimin e palëve të treta, A.B. , U.B. , P.D. , V.K. , I.M. , S.A. , L.D. , A.Gj. , S.A. , A.H. , B.K. , N.G. , L.M. , N.C. , K.P. , S.P. , N.L.-P. , D.K. , I.Rr. , E.P. , V.N. , K.M. , B.F., F.Z. , E.M. , A.M. , L.H. , Y.R. ,L.M. , L.P. , duke çmuar se kanë interes të ligjshme për të paraqitur ankim kundër sekuestros së vendosur ndaj objekteve që posedohen prej tyre në mirëbesim në bazë të veprimeve juridike

të ligjshme.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se palët e treta përmendur më sipër, kanë lidhur për pasuritë e llojit apartament e njësi shërbimi, në zk 8270 nga nr.1-36, kontratat respektive të sipërmarrjes të lidhura midis firmës "Shushica sh.p.k", me investitor L.S. dhe porositësve respektivë të këtyre pronave, me cilësinë e personit të tretë.

Me vendimin nr.01, datë 26.05.2001, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Tiranës, ka miratuar sheshin e ndërtimit, në emër të familjes P. , mbi të cilin më pas i është dhënë Leje Ndërtimi, Subjektit ndërtues "Shushica", me vendimin nr. 18, datë 27.10.2001, në adresën " Margarita Tutulani ", me një afat kohor të kësaj leje, deri më 27.10.2003, për objektet tetë dhe nëntë kate+(1-2) kat parkim nën tokë.

Porositësit (personat e tretë) kanë nënshkruar tek noteri Mimoza Shehu, Kontratat e sipërmarrjes, midis Firmës "Shushica", me investitor L.S. , për secilën nga këto pasuri sipas numrave perkatëse të pasurisë, (apartamentit apo njësi shërbimi e garazh) duke u pasqyruar në këto kontrata të drejtat dhe detyrimet e palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke përcaktuar edhe kështu e pagesës dhe datat e shlyerjes së tyre. Arkëtimi i kështu të vlerës së objektit nga porositësit, është depozituar tek Tirana Bank, sipas vlerës dhe kohës së përcaktuar në këtë kontratë.

Kontratat respektive të sipërmarrjes të lidhura këto në periudhën kohore 2002 e në vazhdim, kanë për qëllim kalimin e pronësisë nga shtetasi L.S. tek palët e treta. Një pjesë e palëve të treta kanë paguar tërësisht çmimin e apartamentit dhe pjesa tjetër kanë paguar kështu sipas afateve dhe shumës së përcaktuar në kontratë dhe kanë mbetur pa paguar kështu e fundit, si garanci për rregjistrimin e sendit në ZVRPP Tiranë.

Pas përfundimit të objektit, të pajisur me leje ndërtimi si më sipër, nga Bashkia Tiranë është lëshuar leja shfrytëzimit të objektit në vitin 2004, duke u përcjellë gjithëdokumentacioni ligjor i këtij objekti tek Z.R.P.P.Tiranë, ku mbi bazën e aplikimit të shtetasit L.S. është realizuar edhe regjistrimi i këtyre pasurive në emër të tij, që në 16.07.2007.

Mbi këto prona që janë nën sekuestro, por në posedim dhe pronësi *de juro* të porositësve (persona të tretë), nga ana e palës sipërmarrëse, L.S. nuk është kryer veprimi juridik i kalimit të pronësisë së objekteve tek porositësit e tyre, për arsye të paqarta për gjykatën.

Gjykata e Apelit në vendimin më sipër, nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e palëve të treta me arsyetimin se, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë fillestare e paraprake të procedimit pasuror parandalues, dhe si rregull i përkasin fazës së konfiskimit të pasurive (neni 21 e vijues i ligjit parandalues), ku barra e provës për të provuar ligjshmërinë e krijimit të këtyre pasurive monetare i takon jo vetëm shtetasit L.S. , që i. l. dyshohet se nuk i ka fituar ligjërisht, por edhe personave të tretë, me të cilët shtetasi i dyshuar S. , pretendon se i ka realizuar kontratat e sipërmarrjes, për disa pasuri të paluajtshme.

Gjatë fazës së hetimit pasuror prokurori urdhëroi kryerjen e ekspertimit datë 11.10.2018, mbi bazën e pyetjeve të shtruar për zgjidhje nga prokurori. Eksperti kontabël ka kryer kontabilizimin e dokumentave që dispononte prokuroria dhe dokumenta të tjera si kontrata e marrëveshje, që kanë vlerë juridike për aktin e ekspertimit, si dhe të dhëna shtesë për të ardhurat personale, si pagat, pensionet,

shitjet e objekteve dhe sidomos bilancet kontable të shoqërisë “Pinari” shpk, të ciat janë tërhequr nga Prokuroria pranë DRT Tiranë.

Gjykata do të bëjë një analizë më të detajuar lidhur me aktin e ekspertimit kontabël më poshtë. Në zbatim të nenit 12/3 të ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, para përfundimit të afatit gjashtëmuor, me kërkesë të prokurorit, Gjykata duke çmuar se kemi të bëjmë me një hetim pasuror të një natyre shumë komplekse, që lidhen me individualizimin e plotë të pasurive të paluajtshme në zotërim të shtetasit L.S. që janë objekt i masave parandaluese, si dhe nevojave për kryerjen e verifikimeve të mëtejshme, kryerjen e një ekspertimi kontabël, për të saktësuar të ardhurat e ligjshme të subjektit të hetimit pasuror L.S. dhe familjarëve të tij të përfutuara ndër vite, për caktimin e shpenzimeve të kryera, pra me qëllim kryerjen e një analize të plotë financiare të transaksioneve të kryera prej subjektit hetimor, për evidentimin e pasurive të pajustificuara, e cila përbën dhe kushtin ligjor të parashikuar nga neni 12 pika 3 e ligjit të posaçëm, disponoj me zgjatjen e afatit të zbatimit të masës masës së sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të vendosura ndaj pasurive të shtetasit L.S., edhe për 6-muaj.

Gjykata referuar nenit 12/b të ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009, nuk çmoi thirrjen e personave të tretë në gjykim, pasi në parashikim të nenit 22/3 të ligjit më sipër thirrja e tyre bëhet kryesisht nga gjykata gjatë procedurës së konfiskimit.

### **III. Pretendimet dhe prapsimet e palëve në gjykim**

**Pala kërkuese gjatë gjykimit dhe në konkluzionet përfundimtare në thelb ka pretenduar se:** Gjatë hetimit të procedimit pasuror Nr.01./2018 në ngarkim të shtetasit L.S. është administruar akti i Ekspertimit Kontabël i datës 11.10.2018, ku eksperti i ka dhënë përgjigje pyetjeve të Prokurorisë dhe ka konkluduar se, teprica e krijuar nga të ardhurat e realizuara duke zbritur shpenzimet e kryera si dhe fakti që ka akoma para për të arkëtuar justifikon të gjitha pasuritë e shtetasit L.H.S. dhe familjes së tij.

Pranë kësaj Prokurorie janë depozituar prova që vërtetojnë se pasuritë apartamente nuk janë në pronësi të shtetasit L.S. , por në pronësi të shtetasve të ndryshëm të cilët e kanë fituar pronësinë nëpërmjet kontratave të porosive, sipërmarrjeve apo premtim shitjeje midis tyre dhe L.S. Të gjitha apartamentet e banimit në pallatin që ka ndërtuar L.S. pavarësisht se figurojnë të rregjistruara ne Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në emër të kërkuesit L.S. , ato janë shitur palëve të treta, edhe posedimi është në favor të të tretëve. Edhe në Gjykatën Apelit, kanë depozituar dokumente ku janë pasqyruar kontratat e sipërmarrjes, dhe kontratat për kalim të drejtash pasurore në favor të të tretëve, por kalimi i pronësisë nuk është kryer për arsye burokratike të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Subjekti L.S. ka depozituar në Prokurori edhe një memo sqaruese ku ka sqaruar të gjithë historikun e tij në lidhje me veprimtarinë ekonomike, pronat e trashëguara nga familja e tij, si dhe ka depozituar dokumente të cilat provojnë se pasuritë e sekuestruara nga ana e Gjykatës janë pasuri të ligjshme dhe të justifikuara, si dhe pasuri të vëna përpara datës 20.05.2010. Sa sipër kërkoj revokimin e sekuestros të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme vendosur me vendimin Nr.04 datë 05.03.2018, të Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Tiranë.

**Pala e interesuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjatë gjykimit dhe në konkluzionet përfundimtare në thelb ka parashtruar se:** Pas sekuestrimit të këtyre pasurive, me vendimin nr.04 datë 05.03.2018 të kësaj gjykate, janë kryer veprime të metejshme hetimore rreth pasurisë së këtij shtetasi, janë administruara disa akte edhe memo të L.S. , ka rezultuar që pavaresisht se këto pasuri aparatamente të sekuestruara kanë figuruar në emër të L.S. , nga dokumentacioni të gjitha këto kanë kontrata porosie në favor të personave të tretë, ku një pjesë kanë shlyer pagesën sipas kontratës dhe ka ngelur pjesa përfundimtare pa shlyer, por ende nuk është bërë regjistrimi në hipotekë.

Ka rezultuar që aktiviteti i shtetasit L.S. ka vijuar nga viti 2000 deri në vitin 2010, shumë kohë përpara se aktiviteti kriminal që na rezulton ne vitin 2010. Nga viti 2000 deri në vitin 2010, është bërë një vlerësim i situatës financiare të këtij shtetasi, nga eksperti kontabël. Pas periudhës Prill Maj 2010 nuk ka pasuri të krijuara, përveç shpenzimeve të llogaritura nga eksperti. Nga analiza financiare, rezultoi se pasuritë e krijuara mbulohen me të ardhurat e krijuara nga ky shtetas, i cili rezulton se aktivitetin e ka filluar në vitin 2000.

Të gjitha trojet e sekuestruara, janë pasuri të fituara me trashëgimi nga nëna e tij F.P.S. Edhe pasuritë e llojit truall që figurojnë të regjistruara në vitin 2013, rezultojnë se janë fituar me trashëgimi përpara vitit 2009, dhe vetëm akti final i regjistrimit është bërë në këtë vit.

Ndërsa lidhur me ullahtet rezulton se janë blerë sipas kontratës së shitblerjes me nr.5562 Rep dhe 1691 Kol datë 22.05.2005, nga shtetasi Sh. B. në vlerën 440.000 dollarë. Kjo periudhë daton pas përfundimit të ndërtimit të pallatit dhe shitjes së apartamenteve tek të tretët, sipas kontratave përkatëse të sipërmarrjeve të ndërtimit të apartamenteve.

Pavarësisht parashikimeve të nenit 3/6, të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, ku si rregull ky ligj i shtrin efektet për pasuritë e vëna pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra pas vitit 2009, ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e vëna përpara hyrjes në fuqi, më kusht që të ekzistojnë indicje të rëndësishme për përfshirjen e tij në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë, lidhur me këtë fakt është hetuar për të gjitha pasuritë e vëna përpara hyrjes fuqi të ligjit.

Nga hetimi i kryer, nga dokumentacioni i mbledhur, si dhe nga akti i ekspertimit kontabël, konkludohet se këto pasuri nuk mund të konfiskohen pasi nuk plotësohen në mënyrë kumulative (të gjitha së bashku) të tre kushtet , a, b, c, të parashikuara nga neni 24 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, u provua se të ardhurat e shtetasit L.S. , si rezultat i aktivitetit ndërtues por edhe i pronave të fituara me trashëgimi nga nëna, janë më të larta se vlera e investimeve dhe shpenzimeve, me një diferencë në shumën 200.972.406 lekë, çka dëshmon se ai e justifikon me burime të ligjshme këto pasuri.

Plotësohet vetëm kushti që shtetasi L.S., është hetuar për një nga veprat që përfshihen në nenin 3 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, por ky kusht nuk mund të veprojë apriori për konfiskimin e pasurive, por duhet të plotësohet në mënyrë kumulative me kushtin tjetër, (neni 11 dhe 24 i ligjit). Sa sipër kërkoj pranimin e kërkesës, revokimin e sekuestros të pasurive të luajtshme dhe të palujtshme vendosur me vendimin Nr.4 datë 05.03.2018, të Gjykatës Shkallës së

Parë për Krime të Rënda Tiranë.

**Provat e shqyrtuara në këtë gjykim.**

Urdhër për regjistrimin e procedimit pasuror, datë 27.02.2018 në ngarkim të shtetasit L.S.; Akti ekspertimi kontabël, përpiluar nga eksperti Qani Kajo,. Bashkëlidhur gjitha bilancet dhe tabelat;Vendim nr.4 dt 5.03.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; Urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr.4 datë 05.03.2018, i Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë datë 06.03.2018; Procesverbal datë 19.03.2018, përpiluar nga oficeri policisë gjyqësore pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve datë 20.03.2018 nga opgj. pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve datë 20.03.2018 nga opgj. pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve datë 21.03.2018 nga opgj. pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve datë 26.03.2018 nga opgj. pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve datë 23.04.2018, nga opgj. pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve datë 10.04.2018 nga opgj. pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli; Procesverbal sekuestrimi i sendeve (automjeteve)datë 08.05.2018, nga opgj.pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë Erjon Karoli. Bashkëlidhur praktikat e regjistrimit te pasurive të paluajtshme; vendimi nr.434 datë 05.02.1996” I komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave ishpronarëve, Bashkia Tiranë, Rajoni 2, ku ishpronarit H. P. (trashëgimtarëve të tij) iu është kthyer trualli me sipërfaqe 11438 m2 e ndodhur në lagjen xxxxx x xx;Vërtetim pronësie datë 23.04.1996 lëshuar nga Hipeteka për regjistrimin e pronave në bazë të vendimit nr. 434 dt 05.02./1996; Vendimi nr. 1098 datë 06.04.2004 I komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave ishpronarëve, ku trashëgimtarëve të pronarit H.P. iu është kthyer trualli i lirë me sipërfaqe 2000 m2, dhembetepërkompesimsipërfaqjaprej 6153 m2; Vendimi nr. 1056 datë 24.06.2003 i komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave ishpronarëve, ku trashëgimtarëve të pronarit H.P. iu është kthyer trualli i lirë me sipërfaqe 700 m2; Kontratë shit-blerje automjeti nr.353 rep, nr.123/1kol datë 02.02.2015 midis palëve L.S. dhe blerës K.B. Bashkëlidhur dokumentat e mjetit; Vërtetim nga dokumenti hipotekor, lëshuar nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme Tiranë me nr.1102 datë 10.07.2017 (bashkëlidhur harta treguese e pasurisë);Praktika e aplikimit;Vërtetim nga dokumenti hipotekor, lëshuar nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme Tiranë me nr.382/8270 datë 20.04.2004(bashkëlidhur harta treguese e pasurisë); Praktika e aplikimit; Kontratë sipërmarrjedatë 12.04.2004, midis Palëve porositëse; -S.P. , Sh.P. , F.K.(P.), F.S.(P.) dhe Sipërmarrësit L.S. , ku pala porositëse i ka vënë në dispozicion sipërmarrësit një sipërfaqe 1434 m2, në rrugën Margarita Tutulani, dhe sipërmarrësi do të ndërtojë një pallat 8 dhe duhet ti jape pales porositëse 27 % tëndërtimit, (dyqaneve, apartamenteve dhe garazheve); Kontratë sipërmarrje datë 27.06.2001 midis Palëve porositëse ; -S.P. , Sh.P. , F.K.(P.), F.S.(P.) dhe Sipërmarrësit L.S. , ku pala porositëse i ka vënë në dispozicion sipërmarrësit një sipërfaqe 555 m2, në rrugën Margarita Tutulani, dhe sipërmarrësi do të ndërtojë një pallat 8-10 katë dhe duhet ti jape pales porositëse 20% të ndërtimit, (dyqaneve, apartamenteve dhe garazheve); Kontratë sipërmarrje, datë 01.02.2013, me nr.3103rep, nr.926/2kol datë 01.02.2013 Dhoma Noterëve Tiranë; Bashkëlidhur vërtetim pronësie nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Lista e bashkëpronarëve. Kartela e pasurisë. Harta treguese; Çertifikatë për vërtetim pronësie nr.56513 datë 14.05.2013; Kontratë sipërmarrje, datë 08.11.2004, me nr.3103rep,

nr.926/2kol datë 01.02.2013 Dhoma Notereëve Tirane; Shkresa nr.638prot datë 23.03.2018 të Prokurorisë për Krime të Reënda, ku i kërkon informacion dhe dokumentacion Zyrës së Urbanistikës Bashkia Tiranë; Praktika pranë Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit; Kontrata sipërmarrjes ndërtim aparatamenti datë 03.09.2002 midis porositësve dhe praktikant për secilin porositës; Kontratë sipërmarrje nr. 7249 Rep dhe nr 1235 Koldatë 01.08.2002 L.S. – F.S.; Kontratë sipërmarrje nr. 7248 Rep dhe nr 1234 Koldatë 01.08.2002 L.S. – S.P.; Kontratë sipërmarrje nr. 9889 Rep dhe nr 1724 Koldatë 30.09.2002 L.S. – Sh. P.; Kontratë sipërmarrje nr. 11582 Rep dhe nr 2017 Koldatë 14.11.2002 L.S.- A.B.; Kontratë sipërmarrje nr. 4735 Rep dhe nr 1063 Kol datë 17.04.2004 L.S.- K.M. dhe S.M.; Kontratë sipërmarrje nr. 9893 Rep dhe nr 1726 Kol datë 30.09.2002 L.S.- E.P.;-Kontratë sipërmarrje nr. 7258 Rep dhe nr 1237 Koldatë 01.08.2002 L.S.- F.K.; Kontratë sipërmarrje nr. 10897 Rep dhe nr 1895 Kol datë 24.10.2002 L.S.- Y.R.; Kontratë sipërmarrje nr. 8413 Rep dhe nr 1543 Koldatë 01.08.2002 L.S. - L.M. ; Kontratë sipërmarrje nr. 1203 Rep dhe nr 1227 Koldatë 31.07.2002 L.S.- B.K.; Kontratë sipërmarrje nr. 8318 Rep dhe nr 1529 Koldatë 02.09.2002 L.S.- L.P.; Kontratë sipërmarrje nr. 10715 Rep dhe nr 1859 Koldatë 22.10.2002 L.S.- N.G.; Kontratë sipërmarrje nr. 11616 Rep dhe nr 2036 Koldatë 16.11.2002 ; L.S.- I.Rr.; Kontratë sipërmarrje nr. 7204 Rep dhe nr 1258 Koldatë 03.07.2002 L.S.- S.A. ; Kontratë sipërmarrje nr. 690 Rep dhe nr 165 Koldatë 03.02. 2002 L.S.- L.H.; Kontratë sipërmarrje nr. 537 Rep dhe nr 98 Koldatë 23.01.2003 L.S. – M. dhe E.B. . Kontratë sipërmarrje nr. 189 Rep dhe nr 23 Koldatë 10.01.2003 L.S.- N.P.; Kontratë sipërmarrje nr. 4344 Rep dhe nr 1067 Koldatë 19.05.2003 L.S.- A. dhe Dh.H. ; Kontratë sipërmarrje nr. 666 Rep dhe nr 160 Kol datë 01.02.2003 L.S. – V.N.; Kontratë sipërmarrje nr. `10851 Rep dhe nr 2185 Kol datë 31.10.2003 L.S. – I.M.; Kontratë sipërmarrje nr. 553 Rep dhe nr .104 Kol datë 24.01.2003 L.S. – P.D.; Kontratë sipërmarrje nr. 4260 Rep dhe nr 974 Kol datë 10.04.2004 L.S.- B. F.. Kontratë kalim kredie dhe premtim shitje Nr. 4902 Rep dhe Nr. 1103 Koldatë 20.04.2004, L.S. dhe L.D.; Kontratë sipërmarrje nr. `10315 Rep dhe nr 3185 Koldatë 15.09.2004 L.S. – E.M.; Kontratë sipërmarrje nr. 11083 Rep dhe nr 2310 Koldatë 15.09.2004 L.S.- F.M.; Kontratë sipërmarrje nr. 7622 Rep dhe nr 1541 Kol datë 16.07.2003 L.S.- E.K.; Kontratë sipërmarrje nr. 7621 Rep dhe nr 1540 Koldatë 16.07.2003 L.S. – B. dhe F.V.; Kontratë sipërmarrje nr. 9668 Rep dhe nr 1740 Koldatë 02.10.2002 L.S. - Shushic Sh.p.k; Akte teknike, kontrata sipërmarrje per ndertim aparatamentit, licensat kolaudusve, akt kontroll piketimi, kontrate sipërmarrje datë 27.06.2001 mes S.P., Sh.P., F.K.(P.), F.S.(P.) dhe Sipërmarrësit L.S. ; Akt marreveshje datë 15.06.2001; Vërtetim pronësie lëshuar nga Zyra Vendore e Pasurive të Paluajtshme Tiranë; Dokumentacione teknike. Licensa e supervisorëve. Licensa e Shushica shpk. Vendimi i KRT-së për shesh ndërtimi. Formular për leje ndërtimi. Dokumentacion për rrjet kanalizimi. Leja shfrytëzimit. Me shkresë 12178/1prot datë 25.12.2004; Kontrata sipërmarrje mes shoqërisë ndërtuesve dhe porositësve bashkë me dokumentacionin teknik për secilin apartament; Kontrata sipërmarrje mes shoqërisë ndërtuesve dhe porositësve bashkë me dokumentacionin teknik për secilin apartament; Dokumentacion



list-pagesa të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, te tatimpaguesi P. me nr.nipt XXXXXXXXXXXX për periudhën tatimore 11/2005 e në vijim, 2006, 2007, 2008,2009, 2010, 2012 muaji shkurt;Nxjerrje llogarie nga Alpha Bank A.E. për llogari të Pinari Shpk, për vitin 2007; Statement banke për shoqërinë Pinari Shpk 2007, ku dokumentohet transfertat e shoqërisë Pinari shpk nga porositësit për pagesën e apartamentit; Çertifikatë për vërtetim pronësie datë 07.06.2005, në favor të L.S. ku dokumentohet pronësia për një truall 355m2 në rruga Hoxha Tahsim Tiranë. Bashkëlidhur kartela pasurisë; Leja e ndërtimit të subjektit Shushica, Lëshuar nga Bashkia Tiranë KRT-ja; Akt kontroll, planimetria, leje shfrytëzimi; Akt kontroll sistemimi; Kontrata shit-blerje toke arë, datë 17.06.2006 nr.4395, nr.1882kol datë 17.06.2006 i Dhomës Noterëve Durreës; Kontrata shit-blerje toke arë, datë 17.06.2006 nr.4896, nr.1883/2 kol datë 17.06.2006 i Dhomës Noterëve Durrës; Statement banke për llogari të L.S. . Statement të bankës Tirana Bank; Kontrata sipërmarrje të lidhura mes shtetasit L.S. 20.07.2005 dhe porositësve, së bashku me praktikën që shoqërojnë kontratën e sipërmarrjes; Leje ndërtimi datë 31.05.2005; Vendim për shesh ndërtimi datë 19.04.2005; Planimetri dhe planvendosje.

### **Vlerësimi i Gjykatës.**

Kjo gjykate në analizë ligjore,të akteve dhe provave të mësipërme, referuar konkluzioneve të aktit të ekspertimit dhe në vështrim të parashikimeve të neneve 21-23 e posaçërisht kriteret e përcaktuara në nenin 24 të ligjit parandalues nr.10 192 datë 03/12/2009, vlerëson se;

Kërkesa e për revokimin e sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të palujtshme vendosur me vendimin Nr.04 datë 05.03.2018, tëGjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në zbatim të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,duhet pranuar, si e bazuar në ligj dhe në prova.

### **Në lidhje me këtë çështje, gjykata nisur nga kërkimi i kërkuesit dhe parashtrimeve të palëve në gjykim, shtron për diskutim çështjen;**

I. Nëse në aspektin formal procedural, pala ndaj së cilës është sekuestruar pasuria, në kuptim tënenit 3 te ligjit Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, bën pjesë në rrethin e atyre personave që përfshihen në dispozitën më sipër si dhe a ka për objekt ato pasuri që përfshihen sipas përcaktimit të këtij neni, pra neni 3 pika 2.

II. A përmbushen në mënyrë kumulative, kushtet e përcaktuara ne nenin 24 /1 germa a,b,c, e ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

Ligji nr.10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, ka për objekt përcaktimin e procedurave, kompetencave dhe kriterëve për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim, dhe së fundmi edhe korrupsion (neni 1).

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar, trafikimit e korrupsionit, përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë

një nivel të pajustificuar ekonomik, të vënë si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale (neni 2).

**Fusha e zbatimit të këtij ligji, referuar nenit 3, përfshin:**

1. Pasuritë e personave për të cilet ka një dyshimi të arsyeshëm bazuar në indicje për pjesëmarrje në listën e veprave penale që gjejne pasyrim në nenin 3 të këtij ligji (pika 1).
2. Pasuritë e personave të afërm me personin mbi të cilin rëndon dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrje në listën e veprave penale që gjejnë pasqyrim në nenin 3 të këtij ligji: (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi) (pika 2.a).
3. Pasuritë e personave fizike dhe juridik, kur ka të dhëna të mjaftueshme që zotërohen, plotësisht qoftë dhe pjesërisht nga personat e dyshuar, në mënyrë të drejtëpërdrejtë a tërthortë, ose janë përdorur, apo kanë lehtësuar, kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të paligjshme nga personat e dyshuar si pjesëmarrës në listën e veprave penale që gjejnë pasyrim në nenin 3 (pika 2.b).

Pra, gjykimi parandalues, masat parandaluese në kuptim të këtij ligji, që janë sekuestrimi dhe konfiskimi janë të lidhura dhe shtrihen mbi pasuritë që rrjedhin nga aktivitetet kriminale të përcaktuara taksativisht në këtë ligj, të vëna gjatë dhe si pasojë e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet dhe nuk shtrihet mbi pasuritë me prejardhje të ligjshme.

Konfiskimi çon në kalimin përfundimtar të pasurisë në favor të shtetit, në rast plotësimi të kushteve të specifikuara në nenin 24/1 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

**Kushtet e parashikuara në nenin 24/1 të sipërcituar janë kumulative dhe mungesa qoftë e njërit prej tyre, çon në rrëzimin e kërkeses së prokurorisë (neni 3) për marrjen e kësaj mase parandaluese.**

Referuar kushteve të vendosura në këtë nen dhe fushës së zbatimit të këtij ligji (neni 3), gjykata çmon se nuk plotësohen, në kuadër të këtij procedimi pasuror kundër të hetuarit L.S. , të gjitha kushtet për marrjen e masës parandaluese të konfiskimit. Këto kushte arsyetohen në këtë vendim, duke u ndaluar dhe argumentuar në vijim.

**Së pari; Shtetasi L.S. është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.**

Në ngarkim të tij, të provuar nga prokurori, i cili ka dhe barrën e provës lidhur me këtë kusht të procedimit pasuror, ka një **dyshimi të arsyeshëm bazuar në indicje**, të rezultuara të konkretizuara në vendimin e Gjykatës Landit të Freiburgu, ku ai është arrestuar në Spanjë për llogari të autoriteve gjermane dhe pas ekstradimit, është hetuar dhe gjykuar në Republikën Federale Gjermane nga Gjykata e Landit të Freiburgu, për veprën penale të parashikuar nga neni 29 a paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit “Për lëndët narkotike”, 25 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës Federale Gjermane si anëtar i një bande. Në përfundim të gjykimit ai është dënuar me një dënim të përgjithshëm prej 5 (pesë) vjet heqje lirie. Ky vendim ka marrë formë të prerë në 6 Prill 2011.

Vendimi në fjalë ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur në datën 20.05.2010, në zonën e Wiil am Reihn, ku shtetasi B.K. , A.Xh., L.S. dhe H.C. i kanë shitur punonjësit të policisë federale gjermane, të infiltruar, një sasi prej 4.5 kg kokainë në këmbim të vlerës prej 216.000 euro.

Duke u nisur nga aktet e administruara nga autoritetet Gjermane të drejtësisë, përfshirja e subjektit në veprimtari kriminale dyshohet se ka ndodhur, **të paktën nga viti 1998 dhe në vazhdim**. Kështu sipas shënimit në dosje, që mban datën 09.10.2010 në kuadër të shkëmbimit të informacionit midis shteteve, jepet njoftimi se nga kërkimet në arkivin shqiptar rezulton se, në datën 13.03.1998 në aeroportin e Fiumiçinos në Romë, ishte ndaluar një koli( ka gjasa të jetë thënë një valixhe) në të cilën ishte fshehur 1.865 gramë kokainë. Kokaina vinte nga Venezuela për në Tiranë dhe marrës duhej të ishte një farë L.S. , në Tiranë. Në vitin 1998 kishte qënë e pamundur për autoritetet Shqiptare të Policisë që të identifikonin tamam se kush ishte L.S. , nuk dihej adresa e saktë. Në atë kohë nuk ekzistonte “mjete i dërgesës së kontrolluar”. Në Shqipëri janë të regjistruar 21 persona me emrin L.S. .

Nga sa më lart u citua, nga aktet e administruara nga autoritetet Gjermane të drejtësisë, Gjykata krijon bindje se ka dyshime të bazuara në indicje se i implikuar në këtë rast është L.S. i biri H. dhe F., i lindur në xx.xx.xxxx, pasi kërkuesi ka udhëtuar për herë të parë në Kolumbi në vitin 1996, ku atje ka njohur edhe bashkëshorten e tij S.P.S. e datëlidjes xx.xx.xxxx, lindur në Bogota/Kolumbi me të cilën ka dy fëmijë, dhe vizitonte rregullisht prindërit e bashkëshortes në Kolumbi, që janë shtete kufitare me Venezuelën. Nga pasaporta e udhëtimit të L.S., mundën të konstatohen për periudhën 1996-2010, gjithsej 33 lëvizje udhëtimesh për në Bogota/Kolumbi. Në rrethanat më sipër ekzistojnë elementë faktikë që krijojnë dyshim të arsyeshëm bazuar në indicje që implikuar në këtë episod është kërkuesi L.S..

Veç kësaj ndaj shtetasin L.S., në vitin 2005 në Itali kishte një shpallje në kërkim ndërkombëtar( të dhëna të tjera nuk jepen, referohu për më tepër faqe 23 dhe 88 vol 2 që i përkasin vendimin nr.4, datë 05.03.2018).

Nga sa më lart u citua, duke marrë parasysh veçantitë që paraqet “grupi i strukturuar kriminal” në kuadër të legjislacionit tonë penal, gjykata vlerëson se kryerja e veprës penale të trafikimit të narkotikëve nga kërkuesi, L.S. është bërë në formën e vecantë të bashkëpunimit, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 28/4 i Kodit Penal, duke qënë kështu subjekt i ligjit të posacëm 10192/2009, sipas pikës 3/1/a/c të këtij Kodi ( pjesëmarrja në organizata kriminale ose grupeve të strukturuar dhe kryerja e krimeve prej tyre ).

Përfshirja e kërkuesit L.S. në veprimtarinë kriminale që kanë gjetur pasqyrim në nenin 3/1 të ligjit 10192/2009, trafikim narkotikësh në formën e pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, bazohet jo vetëm në një **dyshim të arsyeshëm bazuar në indicje** që përbën një nivel më të ulët provueshmërie, por ngrihet në rastin konkret në një nivel më të lartë provueshmërie, pasi ai rezulton të jetë dënuar, me vendimin përmendur më sipër, lidhur ngjarjen e ndodhur në datën **20.05.2010**, por përfshirja e tij në aktivitet kriminal ka ndodhur më herët, **së paku nga viti 1998**.

**Së dyti:** Kërkuesi L.S. , në emër të të cilit rezulton të jetë pasuria, objekt gjykimi nga Prokuroria për Krime të Rënda, nuk është zotërues i të gjitha pasurive objekt i gjykimit, pavarësisht se figuron pronar sipas certifikatave lëshuar nga ZVPP

Tiranë, por pronar *de juro* dhe posedues *de facto* i kësaj pasurie (apartamente-njësi-garazhe zona kadastrale, 8270 nr pasurie 7/299 nr.1-36, të ndodhur në rrugën Sami Frashëri, Tiranë, pallati 9-katësh) janë personat e tretë.

Aktualisht të gjitha këto pasuri rezultojnë të regjistruara në regjistrat publike të

Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë ( regjistrimi publik ) në emër të tij si pronar i vetëm.

Qysh në fazën e zbatimit të vendimit të sekuestrimit të pasurive më sipër, nga oficeri i policisë gjyqësore gjatë procedurës së ekzekutimit, sipas Procesverbal për sekuestrimin e sendeve datë 20.03.2018, është konstatuar se në pasuritë apartamente në zonën kadastrale, 8270 nr. pasurie 7/299 tëndodhur në rrugën Sami Frashëri, Tiranë, pallati 9-katësh, posedoheshin nga familjet përkatëse që i kishin blerë këto pasuri, nga kërkuesi L.S. me kontrata përkatëse të sipërmarrjeve.

Gjatë fazës së hetimit pasuror, marrë shkas sa sipër nga prokurori janë sekuestruar kontratat noteriale të përpiluara përpara noteres Mimoza Shehu, midis sipërmarrësit L.S. dhe personave të tretë. Nga praktikat e kontratave noteriale të përpiluara përpara noteres Mimoza Shehu, midis sipërmarrësit L.S. dhe personave të tretë, rezulton se një pjesë e porositësve kanë paguar tërësisht çmimin e apartamentit, dhe pjesa tjetër kanë pa paguar këstin e fundit si garanci deri në rregjistrimin e pronës, konfirmuar nëpërmjet mandat arkëtimeve të Tirana Bank që shoqërojnë praktikat përkatëse.

Gjykata evidenton se këto apartamente janë të ndërtuara në truallin pasuri trashëgimore, ku një ndër bashkëpronarët është edhe nëna e kërkuesit, F.S.(P.).

Në vijim të hetimit pasuror janë administruar “Kontratë sipërmarrje” datë 27.06.2001 midis Palëve porositëse; S.P., Sh.P., F.K.(P.), F.S.(P.) (nëna e kërkuesit) dhe Sipërmarrësit L.S., ku pala porositëse i ka vënë në dispozicion sipërmarrësit një sipërfaqe 555 m2, në rrugën Margarita Tutulani, dhe sipërmarrësi do të ndërtojë një pallat 8-10 katë dhe duhet ti japë palës porositëse 20% të ndërtimit, (dyqaneve , apartamenteve dhe garazheve)

Kontratë sipërmarrje datë 12.04.2004, midis Palëve porositëse; S.P., Sh.P., F.K.(P.), F.S.(P.) (nëna e kërkuesit) dhe Sipërmarrësit L.S., ku pala porositëse i ka vënë në dispozicion sipërmarrësit një sipërfaqe 1434 m2, në rrugën Margarita Tutulani, dhe sipërmarrësi do të ndërtojë një pallat 8 dhe duhet ti japë palës porositëse 27 % të ndërtimit, (dyqaneve , apartamanteve dhe garazheve |)

Po ashtu janë administruar edhe praktikat për lejet e ndërtimit të kompanive të ndërtimit “Shushica” sh.p.k dhe “Pinari” sh.p.k me administrator L.S. .

**II. Në lidhje me pasuritë e tjera objekt gjykimi** nga hetimi pasuror ka rezultuar se të gjitha trojet që figurojnë në bashkëpronësi të shtetasve, F.H.P., L.H. (S.), M.H.M. (S.), M.H.V. (S.), Sh.H.P., V.H.K., D.F. (S.), H.H.S., S.Sh.P., janë pasuri trashëgimore, të fituara nga nëna e tij, F.S.(P.), në zbatim të ligjit 7698 datë 15.04.1993 “Për kthim dhe kompesim të Pronave ishpronarëve”.

Gjykata po citon më poshtë të gjitha pasuritë e fituara me trashëgimi, nga nëna e tij, F.S.(P.), në zbatim të ligjit 7698 datë 15.04.1993 “Për kthim dhe kompesim të Pronave ishpronarëve”.

Me vendimin nr. 434 datë 05.02.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit Të

Pronave Ishpronarëve Rajoni Nr.2, Tiranë, është njohur pronësia e ishpronarit H.P. , trashëgimtarëve të tij mbi një sipërfaqe trualli prej 11438 m2 dhe i është kthyer sipërfaqe e lirë prej 1910 m2 e ndarë kjo në disa troje ( bashkëlidhur vendimit ndodhet edhe gentplani që shoqëron vendimin më sipër).

Gjithashtu me vendimin nr. 1098, datë 06.04.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit Të Pronave Ishpronarëve, Qarku Tiranë, është kthyer pronësia e ishpronarit H.P. , trashëgimtarëve të tij (cituar më sipër) mbi një sipërfaqe trualli prej 2000 m2( bashkëlidhur vendimit ndodhet edhe gentplani që shoqëron vendimin më sipër).

Po me vendim nr.7056, datë 24.06.2003, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit Të Pronave Ishpronarëve, Qarku Tiranë, është kthyer pronësia e ishpronarit H.P. , trashëgimtarëve të tij(cituar më sipër) mbi një sipërfaqe trualli prej 700m2 e ndarë në dy parcela (bashkëlidhur vendimit ndodhet edhe gentplani që shoqëron vendimin më sipër).

Këto pasuri janë rregjistruar pranë Zyrës Vendosre Të Rregjistrimit të Pasurise të palujtshme Tiranë, sipas vërtetimit hipotekor Nr.1102 datë 10.07.2007, 328/8270 datë 20.04.2004, vërtetim hipotekor Nr.1101 datë 10.07.2007, vërtetim hipotekor Nr.384/8270 datë 20.05.2004, vërtetimit hipotekor Nr.707 datë 14.10.2004,Çertikatë për vertëtim pronësie nr.535614, datë 14.05.2013, Çertikatë për vertëtim pronësie nr.535615, datë 13.05.2013, Çertikatë për vertëtim pronësie nr.535616, datë 11.05.2013, Çertikatë për vertëtim pronësie nr.535613, datë 13.05.2013, Çertikatë për vertëtim pronësie nr.678468, datë 21.01.2013, Çertikatë për vertëtim pronësie nr.678470, datë 22.01.2013, Çertikatë për vertëtim pronësie nr.678407, datë 17.06.2013( bashkëlidhur vertimit hipotekor ndodhet harta treguese e pasurise si dhe kartela e pasurisë së palujtshme) .

III. Pasuria e llojit “Truall + shtëpi banimi”, zk. 8150, Nr. pasurie 4/24 vol 20 fq 140, prej 335 m2 truall nga të cilat 111 m2 ndërtesë, Rr. “xxxx xxxxx” 70/1, regjistruar nëdatën 01.06.2005, është blerë nga shtetasi L.S. në vitin 2001 nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr.7951 rep.nr.1808 kol, datë 12.10.2001, nga pala shitësi H.Q., A.Q., P.Q., V.C.Q., G.Q., A.I.Q., Z.K., F.Q., R.Q., B.T., A.T. dhe M.T. në shumën,2.000.000 lekë.

IV. Ndërsa lidhur me pasuritë e llojit ullishte në emër të kërkuesit L.S. rregjistruar sipas Çertikatës për vertëtim pronësie, nr.ska, datë 16.06.2006, me numër pasurie 51/90, ndodhur në Selitë, rezulton se ato janë blerë nga kërkuesi L.S., sipas kontratës së shitblerjes me nr. 5562 Rep dhe 1691 Kol datë22.05.2005 nga shtetasi Sh.B. në vlerën 440.000 Dollarë.Sipas kërkesës së kërkuesit L.S. , kjo sipërfaqe është ndarë në katër parcela të barabarta prej 4400 m2 dhe janë rregjistruar veçmas në Zyrën e rregjistrimit të Pasurive të paluajtshme Tiranë.

Të gjitha këto pasuri më sipër, si trojet, toka ullishte dhe Pasuria e llojit “Truall + shtëpi banimi”, zk. 8150, Nr. pasurie 4/24, prej 335 m2 truall nga të cilat 111 m2 ndërtesë, Rr. “xxxxx xxxxxxxx (banesa dy katëshe) janë në posedim dhe pronësi individuale apo bashkëpronësi të kërkuesit L.S. me persona të tjerë ku në aspektin formal, në kuptim të nenit 3 të Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 i ndryshuar me ligjin nr.70/2017, përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, pra janë objekt konfiskimi.

**Së treti:** I padituri L.S. provoi se të gjithë pasurinë e vënë, në formën e ndërtimeve apo tokës ullishtë dhe truall, në kushtet e përfshirjes së tij në veprimtarinë kriminale për të cilën shtrin efektet ligji i posaçëm, Nr.10192/2009, janë vënë me të ardhurat e ligjshme të siguruara nga ai dhe familjarët e tij. Vlera e pasurisë së vënë, i përgjigjet dukshëm nivelit së të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe justifikohet prej tij ( gërma “c” e nenit 24/1 të ligjit të sipërcituar ).

Në arsyetimin e këtij kushti thelbësor për konfiskim, gjykata do ti referohet në vijim konkluzioneve të akteve të ekspertimit të kryera gjatë fazës së hetimit pasuror (duke çmuar në lidhje me provat e tjera ), pasi të dhënat e marra gjatë hetimit pasuror përdoren në procedurën e parashkuar nga ky ligj.

Më poshtë po analizojmë në mënyrë të hollësishme e detajuar me radhë të gjitha konkluzionet e aktit të ekspertimit kontabël të pasurisë, lidhur me pasuritë objekt gjykimi.

### **Analiza e aktit të ekspertimit kontabël.**

Në zbatim të vendimit të ekspertimit me aktin e ekspertimit kontabël datë 11.10.2018, mbi bazën e pyetjeve të shtruara për zgjidhje nga prokurori, eksperti ka kryer kontabilizimin e dokumentave që ishin në dosjen e prokurorisë dhe dokumenta të tjera si kontrata e marrëveshje, që kanë vlerë juridike për aktin e ekspertimit, si dhe të dhëna shtesë për të ardhurat personale, si pagat, pensionet, shitjet e objekteve dhe sidomos bilancet kontable të shoqërisë “Pinari” shpk, të cilat janë tërhequr nga Prokuroria pranë DRT Tiranë.

1-Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të krijuara nga shtetasi L.H.S. dhe familjarëve të tij deri në krijimin e aseteve (pasurive) objekt sekuestrimi, eksperti ka kokluduar se Shuma totale e të ardhurave të ligjshme të shtetasit L.H.S. për periudhën 2000-2018 janë në **Shumën 810.295.710 lekë**, sipas pasqyrës pjesë e aktit të ekspertimit. Eksperti në lidhje me të ardhurat për periudhën më sipër ka analizuar të atë ardhurat e realizura nga aktiviteti i kërkuesit, kryesisht në fushën e ndërtimit.

Kështu referuar aktit të ardhurave nga shitja e apartamenteve të ndërtuara në emër të tij si person fizik, sipas dokumentave ligjore dhe ato bankare të paraqitura në emër të L.S. për vitin 2002 – 2018 si :

-Leja e ndërtimit nr. Nr.124 datë 08.01.2002, në favor të firmës “Shushica” shpk si firmë ndërtuese për një pallat 8-9 katë në Rr. Margarita Tutulani” Tiranë.

-Leja e shfrytëzimit të këtij objekti nr.12117 datë 28.12.2004, e cila ka dalë totalisht në emër të L.S. si objekt i përfunduar.

-Kontrata e lidhur me firmën “Shushica” Shpk e lidhur midis L.S. dhe përfaqësuesit të firmës A.D. për përfundimin e ndërtimit në shumën 900.000 USD.

-Kontrata porosie noteriale të noterit Ilir Qevani me blerës të ndryshëm për blerjen e apartamenteve dhe dyqaneve në këtë pallat. Këto kontrata janë të gjitha të parapaguara nga blerësit (për më tepër referohu në faqen nr.3 të aktit ) në Shumën totale 251.526.146 lekë.

-Dokumenta bankare(arkëtimet e bëra në llogaritë personale të L.S. (për më tepër referohu në faqen nr.9 dhe 10 ) në shumën 207.367.758 lekë.

-Leja e ndërtimit nr.199 datë 04/08/2005, e cila ka dalë në emër të shoqërisë Pinari Shpk ku ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë ka qënë L.S. .Ky objekt është ndërtuar nga investitor i vetëm L.S. .Dokumentat shoqëruese janë:Kontratat e lidhura me blerësit për këtë objekt me vlerë totale 5.006.810 Euro dhe 1.800.000 lekë.(Faqe 4 dhe 5).Shpenzimet e këtij pallati u nxorrën nga bilancet e shoqërisë Pinari Shpk të cilat janë të pasqyruara për çdo vit.Për të dy objektet e ndërtuara, janë përpiluar pasqyrat përmbledhëse të ardhurave e shpenzimeve.Të ardhurat personale të familjes, ku përfshihen pagat, pensioni, shitja e pasurive të paluajtshme etj.Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave nga bankat dhe ato me kontrata.

2-Vlera e aseteve (pasurive) të krijuara dhe (sequestruara) mbështetur në vlerën e tregut në momentin e krijimit të tyre;Totali i objekteve të sequestruara është në vlerën **212.095.000lekë**.Në vijim eksperti ka konkluduar se këto vlera janë të vërtetuara plotësisht sepse kanë kontrata të rregullta më firmën që ka kryer ndërtimin e objektit ose shitblerjen.Burimi i mbulimit të këtyre shpenzimeve është mbuluar i gjithë me të ardhurat paraprake që kanë derdhur blerësit.

Refruar aktit, eksperti ka konkluduar se shumta e shpenzimeve të kryera nga shtetasi L.S. dhe familjarët e tij, deri në momentin e krijimit të aseteve objekt sequestrimi ( duke përfshirë këtu edhe shlyerjet e kredive të mundshme të marra); totali i shpenzimeve është **609,323,304 lekë**. Për të për llogaritur nivelin e shpenzimeve të familjes së shtetasit L.H.S. , në mungese të informacionit të saktë, eksperti është bazuar në shpenzimet mesatare të buxheteve të familjes shqiptare që ka publikuar Instituti I Statistikës së Republikës së Shqipërisë. Këto kuota për familjet që merren me biznes janë 2- 3 herë më të larta.Kështu për një familje biznesmenësh, shpenzimet mesatare janë 200.000 deri 250.000 lekë në muaj. Për periudhën 2001 deri 2018, eksperti ka llogaritur shpenzime mesatare 230.000 lekë në muaj. Gjithsej niveli i këtyre shpenzimeve 18 vjet x 12 muaj x 230.000 lekë në muaj = 49.680.000 lekë në total. Në këtë shumë ka përfshirë shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit dhe rregullimet e shtëpive (për më tepër referohu tabelës sipas aktit).

3-Krijimi i ketyre aseteve nga niveli i të ardhurave të krijuara (të ardhura – shpenzime), fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara nga subjekti L.H.S. , sipas dokumentave ligjore që ndodhen në dosjen hetimore, dokumentave kontabël bankare dhe faktit që në periudhën që janë ndërtuar këto objekte, ka pasur shitje qysh në themele, krijimi i këtyre aseteve, por edhe i aseteve të tjera të pa sekustruara, janë plotësisht të ligjshme. Ky subjekt deri në Qershor 2018 ka tepicë të ardhurave mbi shpenzimet (fitim) në **Shumën 200.972.406 lekë** të arkëtuara. Njëkohësisht ka akoma lekë pa u arkëtuar nga kontratat e shitjes edhe **238.483.955lekë**, pasi blerësit do bënë likuidimin përfundimtar me rregjistrimin e pronës, apartamentit (referohu pasqyrës në faqen nr. 2.)

5-Të ardhurat financiare të realizuara nga shtetasi L.H.S. dhe familjarët e tij për periudhën Prill 2010 – Qershor 2018, janë krijuar në vitin 2002 deri në vitin 2010. Në këtë kohë, situata financiare ka qënë me bilanc pozitiv, pra të

ardhurat janë shumë herë më të larta se shpenzimet gjithsej **200.972.406 lekë** .

6-Të ardhurat financiare të realizuara nga shtetasi, L.H.S. dhe familjarët e tij për periudhën Prill 2010 – Qershor 2018, janë të ulta afërsisht **2.353.932 lekë**, duke llogaritur vetëm pensionin e të atit, H.S. .

7-Shpenzimet personale dhe familjare të shtetasit L.H.S. dhe familjarëve të tij për periudhën Prill 2010 - Qershor 2010, janë llogaritur shpenzimet mesatare në mënyrë të njëtrajtshme për gjithë familjen.Gjithsej janë 8 vjet ose 96 muaj x 230000 lekë = **22.000.000 lekë**.

8-Pasuritë e njohura të shtetasit L.H.S. dhe të familjes së tij të krijuara pas periudhës Prill – Maj 2010, dhe në vazhdim, shpenzimet e kryera për fitimin e këtyre pasurive, janë përcaktuar hollësisht dhe veçmas, si dhe vlerën me të cilën janë krijuar secila prej tyre.Kështu Pasuri të paluajtshme të njohura të shtetasit L.H.S.pas muajit Prill- Qershor vitit 2010, dhe deri në vitin 2018 nuk ka, përveç shpenzimeve kohrente.

9-Raporti midis të ardhurave dhe shpenzimeve të shtetasit L.H.S. dhe familjes së tij, për periudhën Prill 2010 – Qershor 2018, në cdo vit, si dhe gjendja e bilancit përfundimtar të tyre, sipas ekspertit është konkluduar se mesatarisht nga muaji Prill – Qershor 2010 deri në Qershor 2018 ka vetëm shpenzime mesatarisht 2.760.000 lekë në cdo vit, kurse të ardhurat kanë qënë mesatarisht 235.983 lekë në vit.

10- **Bilanci përfundimtar** i shtetasit L.H.S. dhe familjarëve të tij, për periudhën 2001 deri qershor 2018 është:

**Të ardhurat në total: 810,295,710 lekë**

**Shpenzimet në total:609,323,304 lekë**

**Fitimi : 200.972.406 lekë**

Në përfundim shuma e të ardhurave totale të familjes së L.H.S. është **810,295,710 lekë**; Shuma e shpenzimeve totale të familjes S. është**609,323,304 lekë**;Teprica e të ardhurave ndaj shpenzimeve është **200.972.406** lekë, dhe mbeten akoma lekë për tu arktuar nga diferenca e shitjeve **238.483.955lekë**.

**Teprica e krijuar nga të ardhurat e realizuara duke zbritur shpenzimet e kryera si dhe fakti që ka akoma lekë për të arktuar, justifikojnë të gjitha pasuritë e shtetasit L.H.S. dhe familjes se tij.**

Gjykata, arsyeton se të ardhurat që përlogariten në kuadër të nenit 24/1/c të ligjit janë ato që kanë prejardhje të ligjshme dhe si të tilla konsiderohen ato që bazohen në të dhënat nga organet tatimore, pasqyrat financiare, ose me veprimtaritë ekonomike të deklaruara dhe jo të ardhurat nga veprimtaritë e padeklaruara.

Bazuar në këtë intepretim, të ardhurat “më prejardhje të ligjshme “ nga aktiviteti që ka ushtruar kërkuesi në fushën e ndërtimit, të shoqërisë “Shushica” dhe “Pinari”sh.p.k., janë pikërisht ato që ka përlogaritur dhe eksperti bazuar në



dokumentacionin zyrtar mbi të ardhurat e deklaruar nga kërkuesi, tërhequr nga Prokuroria pranë DRT Tiranë.

**Gjykata në analizë sa më lart të aktit të ekspertimin, referuar konkluzioneve të tij, konkludon se nuk përmbushen në mënyrë kumulative, kushtet e përcaktuara në nenin 24 /1 gërma a,b,c, e ligjit nr nr. 10192 datë 03.12.2009 i ndryshuar me ligjin nr.70/2017, pasi shuma e të ardhurave totale të familjes së kërkuesit L.H.S. , është më e madhe se shuma e shpenzimeve totale të familjes S., duke justifikuar të gjitha pasuritë e shtetasit L.H.S. dhe familjes së tij.**

**Kushtet e parashikuara në nenin 24/1 të sipërcituar janë kumulative dhe mungesa qoftë e njërit prej tyre, çon në rrëzimin e kërkeses së prokurorisë (neni 3) për marrjen e kësaj mase parandaluese.**

Mbi këtë argumentim në përputhje më kërkesat e nenit 24/1 të ligjit parandalues, kjo gjykatë si gjykata që mund të vendosë edhe konfiskimin e pasurisë (paragrafi i 4 i nenit 12 të ligjit parandalues), vlerëson se nuk ndodhet në këto kushte duke pranuar në bazë të nenit 12/b1 të ligjit parandalues, kërkimin e palëve kërkuesit dhe Prokurorisë për Krime të Rënda, prokurores së çështjes për revokimin e masës së sekuestros.

Referuar në nenin 13 paragrafi i parë të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, një kopje e këtij vendimi t'i përcillet Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratorëve Z.Arjan Baci dhe Z.Erion Ricku, për njoftimin e pronarëve të pasurive të sekuestruara, si dhe të personave të tretë posedues të apartamentevetë sekuestruara.

Në zbatim të nenit 28/6 të ligjit më sipër, urdhërohet policia gjyqësore, oficeri i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit të përpilojë procesverbal për veprimet e ekzekutimit, i cili t'i njoftohet Gjykatës nëpërmjet prokurorit.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, të parapaguara nga shteti, konform nenit 25 pika 3 të ligjit nr. 10192/2009, të përbëra nga shpenzimet e kryera për ekspertimin e kryer gjatë hetimit pasuror siç janë bërë.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata në bazë të neneve 112 dhe 276/1 të K.Pr.Penale, nenet 3/6 , 12/b,1, 13/1 24, 25, 26, dhe 27/1, 28/2/6 të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”i ndryshuar me ligjin Nr.70/2017.

### **V E N D O S I**

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit, L.S..
2. Revokimin e sekuestrimit të pasurisë vendosur me vendimin Nr. 4 datë 05.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për pasuritë e paluajtshme si më poshtë vijon:
  - Pasuri e llojit “Ndërtesë”, zk. 8270 nr. pasurie 7/299, vol 36 fq 76, sipërfaqe 370 m2, Rr. “Sami Frashëri” regjistruar në datë 16.07.2007.
  - Pasuri e llojit “ndërtesë”, zk. 8270 nr. pasurie 7/299- G, vol 36 fq 77, sipërfaqe 197.00 m2, Rr. “Sami Frashëri” regjistruar në datë 16.07.2007.
  - Pasuri e llojit “njësi” zk. 8270 nr. pasurie 7/299 – N1, vol 36 fq 78, sipërfaqe 56 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
  - Pasuri e llojit “G”, zk. 8270, nr. pasurie 7/299 – N2, vol 36 fq. 79, sipërfaqe 90

m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.

- Pasuri e llojit “Njësi”, zk. 8270, nr. pasurie 7/299 – N3, vol 36 fq. 80, sipërfaqe 113 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “Njesi” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 – N4, vol 36 fq. 81, sipërfaqe 55 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 1, vol 36 fq. 82, sipërfaqe 92.35 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 2, vol 36 fq. 83, sipërfaqe 91.03 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 3, vol 36 fq. 84, sipërfaqe 100.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 4, vol 36 fq. 85, sipërfaqe 97.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 5, vol 36 fq. 86, sipërfaqe 92.25 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 6, vol 36 fq. 87, sipërfaqe 91.03 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar ne datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 7, vol 36 fq. 88, sipërfaqe 100.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 8, vol 36 fq. 89, sipërfaqe 97.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 9, vol 36 fq. 90, sipërfaqe 92.25 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 10, vol 36 fq. 91, sipërfaqe 91.03 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 11, vol 36 fq. 92, sipërfaqe 100.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 12, vol 36 fq. 93, sipërfaqe 97.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 13, vol 36 fq. 94, sipërfaqe 92.25 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 14, vol 36 fq. 95, sipërfaqe 91.03 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 15, vol 36 fq. 96, sipërfaqe 100.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 16, vol 36 fq. 97, sipërfaqe 97.22 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.

- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 17, vol 36 fq. 98, sipërfaqe 128.93 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 18, vol 36 fq. 99, sipërfaqe 86.53 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 19, vol 36 fq. 100, sipërfaqe 57.34 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 20, vol 36 fq. 101, sipërfaqe 97.22 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar ne datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 21, vol 36 fq. 102, sipërfaqe 87.64 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 22, vol 36 fq. 103, sipërfaqe 123.72 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 23, vol.36 fq. 104, sipërfaqe 100.36 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar ne datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 24, vol 36 fq. 105, sipërfaqe 58.34 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 25, vol.36 fq.106, sipërfaqe 139.88 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 26, vol 36 fq. 107, sipërfaqe 83.62 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 27, vol 36 fq. 108, sipërfaqe 42.45 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 28, vol 36 fq. 109, sipërfaqe 96.36 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 29, vol 36 fq. 110, sipërfaqe 92.5 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “apartament” zk. 8270, nr. pasurie 7/299 + 1 - 30, vol 36 fq. 110, sipërfaqe 92. 5 m<sup>2</sup>, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 16.07.2007, individuale.
- Pasuri e llojit “Ullishte” zk. 3292, nr. pasurisë 51/103, vol. 18, fq. 176, sipërfaqe4400 m<sup>2</sup>, Selitë, regjistruar në datë 26.09.2006, individuale.
- Pasuri e llojit “Ullishte” zk. 3292, nr. pasurisë 51/102, vol. 18, fq. 175, sipërfaqe4400 m<sup>2</sup>, Selitë, regjistruar në datë 26.09.2006, individuale.
- Pasuri e llojit “Ullishte” zk. 3292, nr. pasurisë 51/101, vol. 18, fq. 174, sipërfaqe4400 m<sup>2</sup>, Selitë, regjistruar në datë 26.09.2006, individuale.
- Pasuri e llojit “Ullishte” zk. 3292, nr. pasurisë 51/100, vol. 18, fq. 173, sipërfaqe4400 m<sup>2</sup>, Selitë, regjistruar në datë 26.09.2006, individuale.
- Pasuria e llojit “Truall + shtepi banimi”, zk. 8150, Nr. pasurie 4/24 vol 20 fq 140, prej 335 m<sup>2</sup> truall nga të cilat 111 m<sup>2</sup> ndërtesë, Rr. “Hoxha Tahsim” 70/1, regjistruar ne 01.06.2005, individuale.

- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/224, vol 22, fq. 166, sipërfaqe 114 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 10.04.2007.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/651, vol 82, fq. 74, sipërfaqe 171 m2, Rr. Margarita Tutulani, regjistruar në datë 28.04.2015.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/649, vol 82, fq. 72, sipërfaqe 70 m2, Rr. Margarita Tutulani, regjistruar në datë 28.04.2015.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/271, vol 28, fq. 159, sipërfaqe 530 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 10.07.2007.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/258, vol 27, fq. 86, sipërfaqe 1,434 m2, Rr. Margarita Tutulani, regjistruar në datë 10.07.2007.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/256, vol 27, fq. 84, sipërfaqe 284 m2, Rr. Margarita Tutulani, regjistruar në datë 10.07.2007.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/270, vol 28, fq. 158, sipërfaqe 25 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar ne datë 10.07.2007.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/644, vol 81, fq. 104, sipërfaqe 452 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 14.10.2014
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/363, vol 77, fq. 232, sipërfaqe 278 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 07.10.2013.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/364, vol 77, fq. 233, sipërfaqe 26 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 07.10.2013.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/176, vol 20, fq. 69, sipërfaqe 560 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 10.07.2007.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/292, vol 32, fq. 119, sipërfaqe 880 m2, Rr. Margarita Tutulani, regjistruar në datë 13.05.2013.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/250, vol 25, fq. 245, sipërfaqe 396 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 13.05.2013.
- Pasuri e llojit “Truall”, zk.8270 nr. pasurisë 7/251, vol 25, fq. 246, sipërfaqe 304 m2, Rr. Sami Frashëri, regjistruar në datë 10.07.2007.

3. Për pasurive të luajtshme si më poshtë vijon:

- Mjeti Tip “Hummer” me targa xxxxx (fillimisht i targuar xx xxxx x), i prodhuar në vitin 2004, në pronësi të shtetasit L.H.S. referuar Çertifikatës së Kontrollit Teknik datë 24.03.2015.
  - Mjeti Tip “MC 01” marka “SMART” me targa xx xxxx x, viti i prodhimit 2000.
  - Mjetin Tip Mercedes – Benz SL320, me ngjyre Blu të hapur dhe targa xxxxxxxx.
4. Revokimin e masës së sekuestros në Qendrën Kombëtare të Bisnesit mbi aksionet e shoqërisë “PINARI” sh.p.k.me administrator, S.P.M. N. me “100%” të kuotave të shoqërisë.
5. Revokimin masës së sekuestros mbi llogaritë bankare të shtetasve H. M.S. dtl. xx.xx.xxxx, L.H.S. dtl. xx.xx.xxxx, F.S. (dtl. xx.xx.xxxx), L. S. (dtl. xx.xx.xxxx), S.P.S. dtl. xx.xx.xxxx, në të gjitha Bankat e Nivelit të Dytë të cilat ushtrojnë aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.
6. Një kopje e këtij vendimi ti përcillet Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratorëve Z.Arjan Baci dhe Z.Erion Ricku përnjoftimin e pronarëve të pasurive të sekuestruara si dhe personave të tretë posedues.

7. Ky vendim të ekzekutohet 15 ditë pas njoftimit të paleve të interesuara.
8. Urdhërohet policia gjyqësore, oficeri i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit të përpilojë procesverbal për veprimet e ekzekutimit, i cili t'i njoftohet Gjykatës nëpërmjet prokurorit.
9. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë brenda dhjetë ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

**U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.01.2019**

**SEKRETARE**

**BLERINA SUKAJ**

**GJYQTARE**

**IRENA GJOKA**

